



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:036772

Datë: 07.05.2024

Numri i dokumentit: 05743417

KA.nr.414/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ të paditësit “M&S Construction” ShPK me NUI 810133364 dhe seli në rrugën Dëshmorët e Kombit p.nr. në Gjilan, si cili sipas prokurës përfaqësohet nga avokati Besim Osmani me seli në rrugën Zenel Salihu, kati III/8 në Prishtinë, kundër të paditurit Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, Inspektorati i Punës me seli në Prishtinë, objekti i kontesti anulimi i aktit administrativ, pas seancës publike të shqyrtimit kryesor të datës 24.04.2024 në të cilën mori pjesë përfaqësuesi i paditësit, në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, më 7 maj 2024 dha këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit “M&S Construction” ShPK me NUI 810133364 ndaj të paditurit Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, Inspektorati i Punës, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr.128/2020 të datës 07.02.2020 të Inspektoratit të Punës si organ administrativ i shkallës së dytë.
- II. Hedhet poshtë padia e paditësit “M&S Construction” ShPK me NUI 810133364 ndaj të paditurit Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, Inspektorati i Punës, në pjesën me të cilën ka kërkuar anulimin vendimit nr.02/b-351 të datës 21.11.2019 të Inspektoratit të Punës si organ administrativ i shkallës së parë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale të shkaktuara lidhur me këtë procedurë.

A R S Y E T I M

I. Padia, kërkesëpadia dhe pretendimet e palëve

1. Paditësi përmes padisë së datës 06.03.2020 e ka iniciuar konfliktin administrativ me kërkesë për anulimin e vendimit nr.128/2020 të datës 07.02.2020 të së paditurit

Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, Inspektorati i Punës, ndërsa përmes parashtrësës së datës 17.04.2024 ka bërë plotësimin e kërkesëpadisë dhe përfundimisht ka kërkuar anulimin e vendimit nr.02/b-351 të datës 21.11.2019 të Inspektoratit të Punës si organ administrativ i shkallës së parë dhe vendimit nr.128/2020 të datës 07.02.2020 të Inspektoratit të Punës si organ administrativ i shkallës së dytë.

2. Ai në padi por edhe gjatë seancës për shqyrtimin e kryesor të çështjes si dhe në fjalën përfundimtare ka pretenduar se, më datë 21.08.2019 rreth orës 07:20 kishte ndodhur një aksident gjatë ushtrimit të veprimtarisë punuese ku ka përfunduar me fatalitet për të punësuarin B.E., i cili ka qenë i punësuar tek punëdhënësi “Rehatija”, për të cilin ka punuar dhe nga i cili është paguar apo kompensuar për shërbimet e kryera dhe jo të kompanisë “M&S Construction”, ngase ai nuk e ka punësuar asnjëherë të ndjerin dhe nuk ka pasur asnjë raport juridik apo faktik me atë. Sipas tij, e tërë referenca e të Padituri, qoftë në raportin zyrtar të datës 21.1.2019 apo në vendimet e kundërshtuara, atë (Paditësin) e kanë konsideruar si punëdhënës i të punësuarit të ndjerë, është referencë e pa ligjshme dhe në kundërshtim me faktet dhe gjendjen faktike, ngase nuk ka asnjë bazë ligjore që përmes nenit 8 par.3 dhe 4 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë të tejkalohej definimet dhe raportet në mes të punëdhënësit dhe të punësuarit, duke e cilësuar Paditësin si punëdhënës të së ndjerit.
3. Në këtë drejtim ka shtuar se termi i përdorur nga i Padituri “Punëdhënësi si investitor”, është definim i paligjshëm ngase neni 5 para.1 dhe 3 i Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, përcakton që punëdhënësi është përgjegjës për të krijuar kushtet e punës të sigurta dhe të shëndetshme në të gjitha aspektet e punës. Sipas tij, ai ka marr leje ndërtimi pikërisht në hapësirën ku është ndërtuar objekti, duke marr pëlqim nga organi kompetent KOSTT, ku ekspertët e KOSTT kanë vlerësuar se në atë hapësirë mund të ndërtohet. Ka pretenduar se legjislacioni për sigurinë dhe shëndetin në punë në tërësinë e tij është i dedikuar për punëdhënësit, e në rastin konkret ai, nuk kishte të punësuar asnjë punëtor që merrej me nivelizim (ibercuk), prandaj edhe ka kontraktuar që këtë punë të kryej një kompani tjetër. Andaj ai nuk mund të bëjë vlerësim të riskut për pozita që nuk kishte. Rregullorja me nr. 03/2014 e cila ishte në fuqi në kohën kur ka ndodhur aksidenti në nenin 5 par.2 përcakton se “përgatitja e dokumentit të vlerësimit të riskut fillon sipas vendimit të marrë nga ana e punëdhënësit për ngritjen procedurës për vlerësimin e riskut duke përcaktuar një ose më tepër persona profesional-ekspertë nga radhët e personave të cilët janë përgjegjës për zbatueshmërinë e procedurës për kryerjen

vlerësimit të riskut”. Kështu që ngarkimi me faj, për mos vlerësim të riskut për të punësuarit e kompanisë “Rehatija”, është i paligjshëm, ngase neni 7 para.1 nënpara.1.1 i Ligjit Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, përcakton se punëdhënësi detyrohet të zbatoj masat parandaluese, për t’i shmangur rrezikut.

4. Ka deklaruar se Inspektorati i punës në vendimet e kontestuara ka pretenduar se nuk është bërë informimi i çdo të punësuarit përpara fillimit të punës për rreziqet ndaj të cilave mund të ekspozohet në vendin e punës si dhe ndaj masave parandaluese dhe mbrojtëse në pajtim me nenin 4 të rregulloren Nr. 04/2016 për kërkesat minimale të shenjave të sigurisë dhe shëndetit në punë, por edhe në këtë rast është përgjegjësi e punëdhënësit, ngase investitori “M&S Construction” SH.P.K nuk mund të informoj dhe trajtoj të punësuarit e kompanive tjera, sikurse dhe nuk mund të blejë pajisjet personale mbrojtëse për të punësuarit e huaj. Sipas tij, i Padituri ka pretenduar se paditësi nuk ka vepruar në përputhje me nenin 16 dhe 20 të Ligjit Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, sa i përket rrezikshmërive në punë dhe trajnimit të punësuarve, por sipas tij investitori nuk ka fare mundësi që të trajtoj të punësuarit e kompanive të tjera para ose pas themelimit të marrëdhënies së punës.
5. I Padituri në përgjigje e tij në padi ka deklaruar se organi i shkallës së dytë pranë inspektoratit të punës pasi ka shqyrtuar ankesën e Paditësit ka gjetur se me vendimin e ankimuar me ankese gjendja faktike edhe e vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, dhe ka vërtetuar vendimin e organit të shkallës së parë të Inspektoratit të Punës.
6. Ka shtuar se e paditura drejtë ka aplikuar dispozitat ligjore, i ka vlerësuar dejtë të gjitha rrethanat dhe provat të cilat kanë ndikuar në nxjerrjen e vendimit ligjor Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit, ndërsa vendimi i Inspektoratit të Punës IP 128/2020 i datës 07.02.2020 të mbetet në fuqi.

II. Provat e administruara dhe gjendja faktike e konstatuar

7. Me qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata i aprovoi të gjitha propozimet e palëve për administrimin e prova. Në këtë drejtim, në seancën për shqyrtimin kryesor u administruan provat si në vijim: vendimi me numër të protokollit 128/2020 i datës 07.02.2020 i Inspektoratit të Punës si organ i shkallës së dytë, vendimi me nr. 02/b-351 i datës 21.11.2019 i Inspektoratit të Punës si organ i shkallës së parë, leja mjedisore komunale me nr. 07-350-100608/18 e datës 10.10.2018, lëshuar nga

DUPMM e komunës së Gjilanit, ankesa kundër vendimit e ushtruar nga paditësi e datës 29.11.2019 me nr. të prot. 04/366, aktmarrëveshja e lidhur në mes të paditësit dhe Rehatia SH.P.K., pa datë, vendimi për leje të ndërtimit me nr. 07-350/02-0104112/18 e datës 10.10.2018 lëshuar nga DUPMM e komunës së Gjilanit, kopja e planit lidhur e njësinë kadastrale P-... lëshuar më datë 09.07.2018 nga Zyra Kadastrale në Gjilan, përgjigja e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut më datë 20.03.2017 ndaj kërkesës me nr. 14 të Xh.M., si dhe shkresat e lëndës të procedurës administrative të dërguara nga i padituri me përgjigje në padi sipas nenit 37 par.2 të LKA-së.

8. Gjykata pas analizimit të provat të cekura më lartë në kuptim të nenit 8 të LPK-së dhe duke i zbatuar rregullat e të provuarit nga neni 322 i LPK-së lidhur me nenin 63 të LKA-së e konstatoi gjendjen faktike të përshkruar më poshtë.
9. Paditësi ishte investitor i objektit të banimit kolektiv në njësinë kadastrale P-... në zonën kadastrale në Shillovë të Gjilanit. Për këtë investim ishte i pajisur me leje mjedisore, leje për ndërtim dhe kishte pëlqim për ndërtimin nga KOSST në afërsi prej 5m distancë anësore ndaj lartëpërquesit.
10. Për nivelizimin e objektit të lartcekur, Paditësi në një ditë të pa caktuar kishte lidhur kontratë me Rehatija ShPK nga Vitia, të cilin e kishte quajtur akt marrëveshje. Në atë kontratë një faqëshe, palët vetëm kishin paraparë punët që do të kryhen, sipërfaqen, çmimin dhe mënyrë e marrëveshjes, ndërsa askund nuk ishte rregulluar përgjegjësia për sigurinë dhe shëndetin në punë.
11. Më 21.08.2019 në vend punishten e objektit të cekur më lartë kishte ndodhur një aksident në punë, për pasoj e të cilit kishte ndërruar jetë punëtori B.E.. Gjykata gjithashtu konstaton se i ndjeri nuk ka qenë në marrëdhënie pune me Paditësin, por nuk ka pasur kontratë të shkruar pune as me Rehatia ShPK. Megjithatë, i nderi ishte i angazhuar për të kryer punë nga Rehatia ShPK.
12. Më 21.11.2019 Inspektorati i Punës duke vepruar në shkallën e parë ka nxjerr vendimin me numër të protokollit 02/b-351, me të cilit i ka shqiptuar Paditësit gjobë në lartësi prej 5500€ për shkak të mos zbatimit të dispozitave nga neni 5 para. 1 dhe 3, nenit 7 para. 11 pika 1.3.1.5 të Rregullores nr. 04/2016, nenit 13 para. 1.3 dhe 1.6, nenit 16 para. 1.2, nenit 20 para. 1 pika 11 dhe nenit 25 të Ligjit nr. 04/L161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (këtu e tutje LSShP).

13. Paditësi më datë 29.11.2019 ka parashtruar ankesë ndaj vendimit të cekur më lartë, ndërsa Inspektorati i Punës si organ administrativ i shkallës së dytë përmes vendimit 128/2020 të datës 07.02.2020, e ka refuzuar ankesën dhe e ka vërtetuar vendimin e organit të shkallës së parë të Inspektoratit të Punës, me arsyetim se barra për krijimin e kushteve për sigurinë dhe shëndetin në punë i bie te Paditësi si investitor nga se i nuk ka lidhur marrëveshje në formë të shkruar për përcaktimin e përgjegjësisë për sigurinë dhe shëndetin në punë, ashtu siç përcaktohet me nenin 8 para .4 të LSShP-së.
14. Provat tjera të administruara nga gjykata nuk provuar ndonjë fakt tjerët relevant lidhur me këtë çështje, prandaj gjykata vendosi të mos lëshohet në elaborimin e hollësishëm të tyre.

III. Vlerësimi meritor i rastit

15. Gjykata në rend të parë e vlerësoi padinë e Paditësit me të cilën është goditur vendimi nr. 02/b-351 të datës 21.11.2019 të Inspektoratit të Punës, si organ administrativ i shkallës së parë, dhe gjeti se ajo në këtë pjesë është e palejueshme.
16. Neni 13 i LKA-së e ka rregulluar se cili akt administrativ i procedurës administrative mund të goditet me padi. Kështu, në para. 1 të nenit 13 të LKA-së parashihet se *“Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë”*, ndërsa para. 2 i po të njëjtit nen ka përcaktuar se *“Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar”*. Sipas këtyre dispozitave juridike, vetëm akti administrativ përfundimtar i nxjerr në shkallën e dytë të procedurës administrative mund të jetë objekt për shqyrtimin e ligjshmërisë në procedurën e konfliktit administrativ, ndërsa akti administrativ i shkallës së parë përjashtimisht mund të jetë objekt i shqyrtimit të ligjshmërisë në procedurën e konfliktit administrativ vetëm nëse ndaj tij nuk lejohet ankesa.
17. Në rastin konkret, vendimi i goditur nr. 02/b-351 i datës 21.11.2019 i Inspektoratit të Punës është akt administrativ i shkallës së parë dhe ndaj tij ka qenë e lejuar ankesa, e madje është ushtruar ankesë në procedurë administrative. Përveç kësaj, ai nuk është akt administrativ përfundimtar. Kjo situatë është e rregulluar me nenin 34 para. 1 nënpara. 1.4 të LKA-së, sipas të cilit *“Gjykata e hedh poshtë padinë me vendim, nëse konstaton*

se: (...) 1.4. kundër aktit administrativ, i cili kontestohet me anë të padisë, mund të bëhet ankimi, kurse ankimi nuk është bërë fare apo nuk është bërë në kohën e duhur;”.

18. Prandaj, për këtë gjykatë padia e Paditësit me të cilin e ka goditur aktin administrativ të shkallës së parë është e palejueshme, rrjedhimisht në bazë të nenit 34 para. 1 dhe 2 të LKA-së, në lidhje me nenin 13 para. 1 dhe 2 të LKA-së e hodhi poshtë padinë, si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.
19. Në lidhje me kërkesëpadinë e Paditësit për anulimin e vendimit nr. 128/2020 të datës 07.02.2020 të Inspektoratit të Punës si organ administrativ i shkallës së dytë, gjykata pas shqyrtimit të të gjitha pretendimeve të ndërgjyqësve, gjendjes faktike të konstatuar si më lartë, si dhe analizimit të dispozitave juridike relevante gjeti se kërkesëpadia e është e pabazuar.
20. Gjykata vlerësoi se i Padituri e ka zbatuar procedurën administrative në përputhje me LPPA-në dhe dispozitat procedurale të paraparë me ligjet e veçanta, të cekur në këtë aktgjykim. Për më tepër, gjykata vlerëson se vendimi i goditur e ka formën e aktit administrativ në përputhje me nenin 47 të LPPA-së si dhe arsyetimi i tij i përmban të gjitha informacionet dhe sqarimet e kërkuara me nenin 48 të LPPA-së. Gjykata rikujton se Paditësi nuk kishte ngritur ndonjë pretendim në këtë aspekt.
21. Po ashtu, gjykata vëren se i Padituri e ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, si dhe nga faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundimin e drejtë të gjendjes faktike. Gjykata rikujton edhe i Padituri kishte konstatuar se personi i ndjerë nuk është i punësuar te Paditësi. As fakti se Paditësi kishte leje ndërtimore për ndërtimin e objektit të banimit kolektiv nuk ishte kontestuese.
22. Përveç kësaj, gjykata vlerëson se i Padituri në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale administrative. Gjendja faktike e përshkruar më lart rregullohet në rend të parë me nenin 8 të LSSH-p-së, i cili në para. 4 ka rregulluar *“Punëdhënësi në cilësinë e investitorit, do të lidhë marrëveshje kontraktuale në formë të shkruar, me personat të cilët kryejnë veprimtari pune për të, përkatësisht me kontraktuesit dhe nënkontraktuesit, në të cilën marrëveshje përcaktohet përgjegjësia për sigurinë dhe shëndetin në punë”*, ndërsa me para. 5 të të njëjtit nen ka sanksionuar se *“Nëse nuk arrihet marrëveshje kontraktuale në pajtim me paragrafin 4. të këtij neni, përgjegjësia për sigurinë dhe shëndetin në punë, sipas këtij ligji, bie mbi investitorin”*. Siç vërehet nga kjo dispozitë,

LSSHp e trajton investitorin si përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë, përderisa ai nuk e bartë këtë përgjegjësi të kryerësi i punës përmes kontratës së shkruar.

23. Gjykata rikujton se kontrata e Padiësisit me kryerësin e punëve Rehatia ShPK nuk e kishte paraparë se përgjegjësinë për sigurinë dhe shëndetin në punë e bartë kryerësi i punimeve, rrjedhimisht në bazë të nenit të cituar më lartë gjykata vjen në përfundim se Padiësi ligjërisht e kishte përgjegjësinë për sigurinë dhe shëndetin në punën në objektin e banimit kolektiv të cekur më lartë.
24. Gjykata e sheh të rëndësishme të sqaroj, se pavarësisht faktit se i ndjeri nuk ka qenë i punësuar te Padiësi dhe faktit se i ndjeri ka qenë i angazhuar nga kryerësi i punimeve Rehatia ShPK, megjithatë ligjërisht Padiësi si investitor ka qenë i obliguar që të kujdeset për sigurinë dhe shëndetin në punë, gjegjësisht në rastin konkret të krijoj kushte pune për parandalimin e rreziqeve në punë, për zbatimin e masave parandaluese për shmangien e rrezikut nga rryma, të informoj të gjithë të punësuarit para fillimit të punës për rreziqet të cilave mund tu ekspozohen dhe masat parandaluese ndaj këtyre rreziqeve dhe të bëj vlerësimin e rreziqeve në punë me qëllim të parandalimit të tyre.
25. Fakti se Padiësi ka pasur leje ndërtimore dhe pëlqimet e nevojshme nuk e amnistojnë atë që të ndërmarr veprime për sigurimin e vendit të punës. Lejet dhe pëlqimet paraqesin vetëm kusht themelor për fillimin e punës, pra përcaktojnë kushtet dhe kufijtë e punimeve, por nuk nënkupton se investitori nuk duhet që të marrë masa për sigurimin e vendit të punës.
26. Në anën tjetër, sipas nenit 25 i LSSHp-së i ka rregulluar sanksionet në të holla për shkeljet e ligjore, duke rregulluar se “1. Personi fizik dhe personi juridik, që nuk i zbaton dispozitat e këtij ligji, në procedurë ligjore do të dënohet në të holla për secilën dispozitë të shkelur. 2. Për shkelje të dispozitave të nenit 5, 6, 9 dhe 10 të këtij ligji, punëdhënësi do të dënohet në të holla në shumën prej pesqind (500) deri në dhjetmijë (10.000) Euro. 3. Për shkeljet e dispozitave të nenit 7, 11, 12, 13, 15 dhe 17 të këtij ligji, punëdhënësi do të dënohet në të holla në shumën prej pesqind (500) deri tridhjetepesëmijë (35.000) Euro. 4. Për shkeljet e dispozitave të nenit 8 të këtij ligji, investitori, kontraktuesi, ose nënkontraktuesi do të dënohet në të holla në shumën prej pesmijë (5.000) deri tridhjetepesëmijë (35.000) Euro. 5. Për shkeljet e dispozitave të nenit 14 dhe 16 të këtij ligji, punëdhënësi do të dënohet në të holla në shumën prej pesqind (500) deri njëzetepesëmijë (25.000) Euro. 6. Për shkeljet e dispozitave të nenit

18 dhe 19 të këtij ligji, punëdhënësi do të dënohet në të holla në shumën prej pesqind (500) deri pesëmbëdhjetëmijë (15.000) Euro. 7. Për shkeljet e dispozitave të nenit 20, 22 dhe 23 të këtij ligji, punëdhënësi do të dënohet në të holla në shumën prej pesqind (500) deri njëzetmijë (20 000) Euro. 8. Për shkeljet e dispozitave të nenit 21 të këtij ligji, i punësuar do të dënohet në të holla në shumën prej njëqind (100) deri pesëmijë (5.000) Euro”. Nga këto dispozita kuptohet se LSSH P ka paraparë sanksione për shkeljet e këtij ligji, të cilat i Padituri ka qenë i autorizuar t’i shqiptoj sipas nenit 3 para. 1 nënpara. 14 të LSSH P-së lidhur me nenin 5 para. 2 pika c) e Ligjit nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës (me ndryshime).

27. Gjykata sqaron se meqenëse i Padituri e ka shqiptuar sanksionin në kufijtë e lartësisë minimale të gjobës, atëherë gjykata vlerëson se gjoba është proporcionale me të gjitha shkeljet e konstatuara.
28. Prandaj, meqenëse i Padituri ka qenë kompetent për të nxjerr vendimin e goditur, procedura që i ka paraprirë nxjerrjes së aktit administrativ të goditur është zbatuar në tërësi sipas rregullave të procedurës administrative, duke qenë se i Padituri ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm për të gjitha çështjet relevante të rastit, duke marrë parasysh se i Padituri e ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, si dhe nga faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundimin e drejtë të gjendjes faktike, siç është sqaruar edhe në pjesën e gjendjes faktike në këtë arsyetim, gjykata vjen në përfundim se nuk është plotësuar asnjë kusht ligjore nga LPPA dhe LKA për anulimin e aktit administrativ të goditur, rrjedhimisht e refuzoi kërkesëpadinë e Paditësit.
29. Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 64 të LKA-së, meqenëse Paditësi e kishte kërkuar shpërblimin e tyre përmes padisë.
30. Bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të LKA, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës

Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.414/22

Gjyqtari

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktgjykimit mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.